



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 865/8 prot

Datë 14.07.2023

V E N D I M

Nr. 624/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.07.2023 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Vibtis” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59068-02-15-2023, me objekt: “Blerje koshash për mbetjet urbane”, me fond limit 8,330,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Luar Bros” SHPK
Rruga “Nasi Pavllo”, pall 15/1, Shkalla 1, Apartamenti nr. 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Himarë
Spile, Himarë

Subjekte të Interesuara:

“Vibtis” SHPK

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla nr. 2 , Kati 8/4, Tiranë

“Alko Impex Construction” SHPK

Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Asim Vokshi", Alb building 2t, kati i 2, Tiranë

“Sark” SHPK

Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skenderbej, Fier, Rajoni nr. 3, Përballë supermarket Lalaj, Fier

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.3. Operatori ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.5. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.02.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59068-02-15-2023, me objekt: “Blerje koshash për mbetjet urbane”, me fond limit 8,330,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

II.2. Në datën 10.03.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 05.04.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Vibtis ” SHPK	6,999,250 lekë,	kualifikuar
2. “Alko Impex Construction” SHPK	7,300,000 lekë,	kualifikuar
3. “Sark” SHPK	7,920,000 lekë,	kualifikuar
4. “Luar Bros” SHPK	8,286,000 lekë,	kualifikuar

II.4. Në datën 19.04.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 24.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 865 protokollit e operatorit ekonomik “Luar Bros ” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59068-02-15-2023, me objekt: “Blerje koshash për mbetjet urbane”, me fond limit 8,330,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Vibtis” SHPK, “Alko Impex Construction” SHPK, dhe “Sark” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.865/2 prot, datë 25.04.2023, duke referuar kriteret të cilat operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë “Vibtis” SHPK, “Alko Impex Construction” SHPK, dhe “Sark” SHPK.

II.7. Në datën 02.05.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 865/3 prot., formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatori ekonomik i interesuar Vibtis” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik.”

II.8. Me shkresat nr. 865/4 prot., datë 15.05.2023 dhe nr. 865/5 prot., datë 21.06.2023, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor mbi detyrimin e këtij të fundit për dhënie informacioni KPP-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK.

II.9. Autoriteti me datë 11.07.2023, përmes komunikimit elektronik zyrtar, ka dërguar në KPP informacion lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës, i cili u protokollua me tonën me nr. 865/6 prot., datë 11.07.2023 dhe duke cituar: “*Më datë 20.02.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë, procedura e tenderit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mallra”, me NR. REF-59068-02-15-2023, me objekt: “Blerje koshash për mbetjet urbane”, me fond limit prej 8 330 000 (tetë milion e tre qind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH.*

Më datë 20.04.2023, pranë autoriteti kontraktor është depozituar ankesa mbi vlerësimin e procedurës me objekt “Blerje koshash për mbetjet urbane”, nga operatori ekonomik “LUAR Bros” SHPK, me anë të së cilës kërkohet : “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Vibtis” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59068-02- 15-2023, me objekt: “Blerje koshash për mbetjet urbane”, me fond limit 8,330,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit. ”

Me marrjen e ankesës, titullari i autoritetit kontraktor ka urdhëruar njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojë procedurën e tenderit.

Pas shqyrtimit të ankesës, autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “LUAR Bros” SHPK.

Për shkaqe të pavarura nga vullneti i autoritetit kontraktor që lidhen me largimin e nepunësve civil nga pozicioni i punës, nuk është realizuar komunikimi i këtij vendimi operatorit ekonomik “LUAR Bros” SHPK.

Aktualisht procedura e prokurimit vijon të jetë e pezulluar, deri në përfundimin e procedurës së ankimit dhe marrjen e një vendimi përfundimtar.

***Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,
Bashkëlidhur kësaj shkrese:***

- *Procesverbalet e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje koshash për mbetjet urbane”;*
- *Dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomikë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE).”*

II.10. Informacioni i mësipërm i autoritetit kontraktor u depozitua në KPP edhe përmes shërbimit postar me shkresën me nr. 2353/2 prot., datë 12.07.2023, e cila u protokollua me tonën me nr.14.07.2023 me nr. 865/7 prot.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Sark” SHPK të kriterit 2.3.3 në kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht për specifikimet teknike të parashtruara në ankesë dhe të paraqitura edhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit me nr. 865/2 prot., datë 25.04.2023, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, për këtë pretendim, operatori ekonomik ankimues, nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me mosplotësimin e kriterit 2.3.3 në kriteret e veçanta për kualifikim.

III.1.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe *“elementet e domosdoshme të ankesës”* sipas përcaktimeve të nenit 48, *“Kushtet formale të ankesës”*, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.1.2. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Sark” SHPK të kriterit 2.3.3 në kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht për specifikimet teknike të parashtruara në ankesë dhe të paraqitura edhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit me nr. 865/2 prot, ankimuesi “Luar Bros” SHPK duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit

kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin, etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësi e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krahasim të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.1.6. Një pretendim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar para tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim

me qëllimin e veprimitarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e saj, KPP zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një pretendim, i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Luar Bros”, për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Sark” SHPK të kriterit 2.3.3 në kriteret e veçanta për kualifikim, konkretisht për specifikimet teknike të parashtruara në ankesë dhe të paraqitura edhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit me nr. 865/2 prot., datë 25.04.2023, nuk merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Luar Bros” SHPK, se operatori ekonomik “Sark” SHPK nuk ka në fushën e veprimitarisë objektin e prokurimit, KPP vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “a” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimitarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

[...]

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

III.2.2. Në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITERËVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimitarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

III.2.3. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Sark” SHPK rezulton, se është paraqitur:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

PO.Është i regjistruar ne regjistrin tregtar sipas legjislacionit OKB dhe ka status AKTIV

III.2.4. Neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se:

“Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

III.2.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të

zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.8. Lidhur me pretendimet e ankimesve për sa i përket objektit të veprimtarisë së operatorit ekonomik “Sark” SHPK, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në fjalë rezultojnë, se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “A” “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, është deklaruar: “Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

PO.Është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit QKB dhe ka status AKTIV.” Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit historik të regjistrit për të dhënat e subjektit “Sark” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezultojnë, se objekti i aktivitetit është përcaktuar: “Import-eksport ,tregtim me shumice dhe pakice të mallrave farmaceutike, barna mjekësore, materiale me përdorim dentar, klinike mjekësore, ndërtim të

banesave, objekte industriale, vepra bonifikimi, ujesjellesa-kanalizime, tregti dhe import-eksport te mallrave te ndryshme si dyer, dritare, tregtim i lendeve te para per industrine, hidrosanitare, paisje elektroshtepiake, makineri te ndryshme, pjese kembimi, bime mjekësore, pijë alkoolike, barbufe etj. Sherbime dhe mirëmbajtje te sistemeve elektrike dhe elektronike ,sisteme te peshimit, shpim pusesh per uji. Tregtim te vajrave lubrifikante me pakice etj. Nderitim rrugesht te kategorive te ndryshme. Grumbullim dhe largim te mbeturinave urbane, ngritjen e nje zyre Punesimi, Ndermjetesim ne tregun e punes. Kodi III.1.A Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme. Kodi III.2.A (1+2). Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis. Kodi III.1.B Transportim i mbetjeve jo te rrezikshme. Kodi III.1.B Leje Mjedisi e Tipit B. Kodi III.2.B Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis. Kodi III.7.B Shpues profesional per uje. Punime ne bujqesi dhe blegtori. Shitje-blerje pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, agjenci per blerje-shitje bileta udhetimi turistike, hoteleri, organizim evente, pagesa uji, drita, telefoni, gjoba makinash, etj. Agjent per sigurine. Prodhim ,shitje shumice pakice barna mjeksore. Punime ndertimore ne kuader te reabilitimit te qendres aktuale dhe ngritjes se infrastruktures". Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Sark" SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar formulari i pergjithshëm i vetëdeklarimit, lidhur me objektin e veprimtarisë së tij, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë "Sark" SHPK, sipas ekstraktit historik si më sipër cituar rezulton, se përfshihet objekti i prokurimit.

Sa më lart pretendimi i i operatorit ekonomik "Luar Bros" SHPK, nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Luar Bros" SHPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë "Alko Impex Construction" SHPK dhe "Vibtis" SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik "Sark" SHPK përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP-së do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimesit në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë "Alko Impex Construction" SHPK dhe "Vibtis" SHPK, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt-prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave

Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59068-02-15-2023, me objekt: “Blerje koshash për mbetjet urbane”, me fond limit 8,330,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 10.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri